

VENDIM
Nr. 688, datë 18.11.2021

**PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË PËR PUNONJËSIT E
GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

(ndryshuar me VKM nr. 623, datë 28.9.2022, nr. 239, datë 20.4.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të pikave 1, shkronja “a”, dhe 2, të nenit 48, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e pagës mujore dhe vlerat e pagave e të shtesave mbi pagë për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë janë, si më poshtë vijon:

a) paga mujore për gradë është sipas kolonës 3, të lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi e është pjesë përbërëse e tij, dhe përfaqëson nivelin e pagës së punonjësit, në përputhje me gradën që ka fituar brenda rolit përkatës;

b) shtesa mujore për natyrë të veçantë pune, për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë, është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) shtesa mujore mbi pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin është sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ç) shtesa mujore mbi pagë për vjetërsi shërbimi është shtesa që përfiton punonjësi i Gardës së Republikës së Shqipërisë për çdo vit shërbimi. Kjo shtesë aplikohet në përqindje mbi pagën për gradë të gradës “Inspektor” dhe jepet në masën 1% për çdo vit, por jo më shumë se 25 vjet.

2. Për efekt të llogaritjes së shtesës mujore mbi pagë për vjetërsi shërbimi, sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të këtij vendimi, vite shërbimi do të konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara në librezën e punës së çdo punonjësi në strukturat e Gardës së Republikës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Forcave të Armatosura, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Policisë së Burgjeve, si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.

3. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e vjetërsisë në shërbim për efekt pagese janë vitet e sigurimit vullnetar, të vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa grada, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Brendshme e të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.

4. Punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë, të cilët deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi përfitonin pagë mujore më të lartë se ajo e përcaktuar në këtë vendim, do të përfitojnë “ruajtje page”, por jo më shumë se dy vjet nga data e fillimit të zbatimit të këtij vendimi.

5. Masa e “ruajtjes së pagës”, sipas pikës 4, të këtij vendimi, do të jetë e barabartë me diferencën e pagës mujore që punonjësi përfitonte përpara miratimit të këtij vendimi me pagën mujore sipas përcaktimit të këtij vendimi. Kjo shtesë rillogaritet në çdo rast kur bëhen ndryshimet për pagat për gradë, sipas strukturës dhe organikës së miratuar.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 551, datë 15.7.2020, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nr. 639, datë 29.7.2020, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohen.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për Gardën e Republikës së Shqipërisë.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 dhjetor 2021.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

PAGA MUJORE PËR GRADË PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(ndryshuar me VKM nr. 623, datë 28.9.2022 dhe nr. 239, datë 20.4.2023)

Roli i punonjësve sipas gradave	Grada	Paga mujore për gradë
1	2	3
Për punonjësit e nivelit madhor	Drejtues madhor	133 700
	Drejtues i lartë	123 000
Për punonjësit e nivelit të lartë	Drejtues i parë	115 000
	Drejtues	106 000
Për punonjësit e nivelit të mesëm	Kryekomisar	93 000
	Komisar	82 500
	Nënkomisar	75 000
Për punonjësit e nivelit bazë	Inspektor i parë	64 000
	Inspektor i dytë	61 500
	Inspektor	59 000

Lidhja nr. 2

MASA E SHITESËS MUJORE PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE, PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nr.	Funksionet organike në strukturat e Gardës së Republikës	Masa mujore e shtesës në lekë
1	Drejtor i përgjithshëm i Gardës së Republikës	40 000
2	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Gardës së Republikës	35 000
3	Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit	30 000
4	Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e PLSH-së	
5	Shef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Presidentit të Republikës, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
6	Zëvendësshef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Presidentit të Republikës, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
7	Truprojë dhe truprojë-shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Presidentit të Republikës dhe familjes së tij, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
8	Shofer (makinë policie), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Presidentit të Republikës, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
9	Shef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryetarit të Kuvendit, në Drejtorinë për	

	Sigurinë e PLSH-së	
10	Zëvendësshef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryetarit të Kuvendit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
11	Truprojë dhe truprojë-shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryetarit të Kuvendit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
12	Shofer (makinë policie), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryetarit të Kuvendit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
13	Shef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryeministrit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
14	Zëvendësshef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryeministrit dhe familjes së tij, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
15	Truprojë dhe truprojë-shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryeministrit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
16	Shofer (makinë policie), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryeministrit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
17	Shef njësie, në Njësinë e Dytë dhe në Njësinë Speciale	
18	Zëvendësshef njësie, në Njësinë Speciale	
19	Specialist për shërbimet, në Njësinë Speciale	
20	Specialist për stërvitjen dhe trajnimet, në Njësinë Speciale	
21	Shef sektori në Njësinë Speciale	
22	Trup shërbimi special në Njësinë Speciale	
23	Përgjegjës për shërbimin e gatshëm në Njësinë Speciale	
24	Trup shërbimi - shofer në Njësinë Speciale	
25	Zëvendësdrejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit	
26	Zëvendësdrejtor i Drejtorisë për Sigurinë e PLSH-së	
27	Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
28	Shef njësie në Njësinë e Parë	
29	Shef njësie në Njësinë e Tretë	
30	Shef njësie në Njësinë e Katërt	
31	Truprojë për Zëvendëskryeministrin	
32	Shef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Prokurorit të Përgjithshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
33	Truprojë dhe truprojë-shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Prokurorit të Përgjithshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
34	Shef sektori, në Sektorin për Sigurinë Fizike të ministrit të Brendshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
35	Truprojë, në Sektorin për Sigurinë Fizike të ministrit të Brendshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
36	Truprojë - shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të ministrit të Brendshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
37	Shofer (makinë policie), në Sektorin për Sigurinë Fizike të ministrit të Brendshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
38	Shef i Kabinetit	
39	Shef sektori, në Sektorin për sigurinë e Personaliteteve Shtetërore, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
40	Zëvendësshef sektori, në Sektorin për Sigurinë e Personaliteteve Shtetërore, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
41	Truprojë dhe truprojë-shofer, për personalitetet shtetërore dhe ish-personalitetet e larta shtetërore, në Sektorin për Sigurinë e Personaliteteve Shtetërore, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
42	Shef sektori, në Sektorin e Sigurisë së Delegacioneve, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
43	Shef seksioni, në Sektorin e Sigurisë së Delegacioneve, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
44	Truprojë dhe truprojë-motoçiklist ceremonial, në Sektorin e Sigurisë së Delegacioneve, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
45	Shofer, në Sektorin e Sigurisë së Delegacioneve, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
		25 000
		20 000
		17 500
		15 000

46	Zëvendësdrejtor, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
47	Shef sektori, në Sektorin për Sigurinë e drejtuesve të SPAK-ut dhe gjykatave, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
48	Zëvendësshef sektori, në Sektorin e për Sigurinë e Drejtuesve të SPAK-ut dhe gjykatave, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
49	Truprojë dhe truprojë - shofer, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
50	Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse	
51	Shef i Qendrës së Aftësimin Profesional	
52	Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore	
53	Shef i Sektorit të Buxhet-Financës	
54	Shef i Sektorit të Analizës	
55	Shef i Sallës Operative	
56	Shef i Sektorit të Prokurimeve	
57	Shef i Sektorit të Informimit të Brendshëm	
58	Zëvendësshef njësie në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë, në Njësinë e Tretë dhe në Njësinë e Katërt	
59	Shofer për kabinetin në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
60	Specialist për formimin dhe trajnimet, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit	
61	Specialist për qarkullimin rrugor, në Drejtorinë e Planifikimit, dhe Kontrollit	
62	Specialist për planifikimin, në Drejtorinë e Planifikimit, dhe Kontrollit	
63	Specialist për komunikimin dhe statistikat	
64	Psikolog	
65	Shofer në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit	
66	Specialist për shërbimet, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
67	Specialist për shërbimet e PLSH-së, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
68	Specialist për stërvitjen dhe transportin, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
69	Specialist për teknologjinë e informacionit, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
70	Specialist për mjetet lundruese (komandant motoskafi) në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
71	Ndihmëspecialist për mjetet lundruese (marinar) në sektorin e transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
72	Shofer, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
73	Trup shërbimi, në Sektorin për Sigurinë e PSH-së, në Drejtorinë për Sigurinë e PLSH-së	
74	Specialist për shërbimet, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
75	Shofer në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	
76	Trup shërbimi në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	12 000
77	Specialist për shërbimet dhe trajnimin, në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë dhe në Njësinë e Tretë	
78	Shef sektori, në sektorët në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë, në Njësinë e Tretë dhe në Njësinë e Katërt	
79	Zëvendësshef sektori, në sektorët në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë, në Njësinë e Tretë dhe në Njësinë e Katërt	
80	Shef seksioni, në sektorët në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë dhe në Njësinë e Tretë	
81	Trup shërbimi në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë, në Njësinë e Tretë dhe në Sektorin për Sigurinë e Vendvendosjes së Gardës në Njësinë e Katërt	
82	Trup shërbimi ceremonial, në të gjitha strukturat	
83	Asistues për PLSH-në	
84	Shef sektori, në Sektorin e Policisë Parlamentare	
85	Zëvendësshef sektori, në Sektorin e Policisë Parlamentare	
86	Trup shërbimi, në Sektorin e Policisë Parlamentare	
87	Specialist për shërbimet, në Njësinë e Katërt	
88	Shef sektori, për ruajtjen e rezidencave qeveritare e OKV	
89	Shofer, në Njësinë e Katërt	
90	Specialist dhe ndihmëspecialist i ruajtjes nga incidentet me LE dhe ASHM në të gjitha strukturat	

91	Instruktor për qenin eksplozivkërkues	
92	Shef sektori, në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës	
93	Shef sektori, në Sektorin e Armatimit dhe Pajisjeve	
94	Shef seksioni, në Sektorin e për Ruajtjen e Rezidencave e OKV	
95	Shef sektori, në Sektorin e Programimit dhe Stërvitjes, në Qendrën e Aftësimi Profesional	
96	Shef sektori, në Sektorin e Ruajtjes së Objektivit, në Qendrën e Aftësimi Profesional	
97	Shef sektori, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
98	Shef sektori, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
99	Shef sektori, në Sektorin e Protokoll-Arkivit	
100	Shef sektori (mjek), në Sektorin e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
101	Specialist (mjek), në Sektorin e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
102	Specialist (kryeinfermier), në Sektorin e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
103	Specialist (infermier), në Sektorin e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
104	Specialist, në Sektorin e Analizës	
105	Specialist, në Sektorin e Informimit të Brendshëm	
106	Ndihmësspecialist, në Sektorin e Informimit të Brendshëm	
107	Ndihmësspecialist për shërbimin e brendshëm në të gjitha strukturat	
108	Specialist në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës	
109	Ndihmësspecialist (shofer), në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës	
110	Llogaritar për armatimin, në Sektorin e Armatimit dhe Pajisjeve	
111	Teknik mirëmbajtjeje, në Sektorin e armatimit dhe pajisjeve	
112	Zëvendësshef seksioni, në Sektorin për Ruajtjen e Rezidencave e OKV, në Njësinë e Katërt	
113	Trup shërbimi dhe shofer, në Sektorin për Ruajtjen e Rezidencave e OKV, në Njësinë e e Katërt	
114	Instruktor për palestrën	
115	Specialist në Sektorin e Programimit dhe Stërvitjes, në Qendrën e Aftësimi Profesional	
116	Specialist dhe ndihmësspecialist i administrimit të mjeteve, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
117	Specialist i shfrytëzimit të mjeteve, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	10 000
118	Specialist për riparimin e mjeteve, në Sektorin E Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
119	Kolaudator i mjeteve, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
120	Specialist, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
121	Trup shërbimi në Sektorin e Ruajtjes së Objektivit, në Qendrën e Aftësimi Profesional	
122	Specialist, në Sallën operative	
123	Specialist, në Sektorin e Burimeve Njerëzore	
124	Specialist, në Sektorin e Buxhet-Financës	
125	Specialist, në Sektorin e Prokurimeve	
126	Këshilltar në Kabinet	
127	Këshilltar juridik në Kabinet	
128	Asistent në Kabinet	
129	Asistent për zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Gardës së Republikës	
130	Përgjegjës material, në të gjitha strukturat	
131	Ndihmësspecialist për Multimedian	
132	Teknik ndërtimi, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
133	Teknik mirëmbajtjeje, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
134	Automekanik, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
135	Përgjegjës punëtorie, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
136	Ndihmësspecialist i administrimit të mjeteve, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
137	Automekanik, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
138	Specialist arkivi, në Sektorin e Protokoll-Arkivit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	5 000

139	Shofer, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	
141	Korrier (shofer), në Sektorin e Protokoll-Arkivit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	

Lidhja nr. 3

MASA E SHITESËS MUJORE PËR PUNË TË VËSHTIRA E TË DËMSHME PËR SHËNDETIN, PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nr.	Funksionet organike në strukturat e Gardës së Republikës së Shqipërisë	Masa e shtesës mujore në lekë
1	2	3
1	Ndihmëspecialist në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës; Specialist - motorist automekanik, përgjegjës VKT-je, elektrikist, elektroaut, baterist, saldator.	3 000
2	Mjek; Kryeinfermier; Infermier.	2 000
3	Arkivist Protokollist/arkivist	1 500